



Aktivizimi i tregut të punës për grupet vulnerable



Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian

Agjencia e Punësimit, në kuadër të projektit të financuar nga BE-ja “Aktivizimi i tregut të punës për grupet vulnerabel”, shpall

THIRRJE
PËR SHPREHJE TË INTERESIT DHE FTESË PËR TENDER
për
shërbime këshillimi dhe motivimi – Mbështetje mentorimi
për aktivizimin (integrimin) e shfrytëzuesve të NGM-së në tregun e punës

Nr. ref. 12-7581/1-6.2

Reforma në sistemin e mbrojtjes sociale përmes Ndhmës së garantuar minimale (NGM) përfshin aktivizimin e përforcuar të shfrytëzuesve të NGM-së. Projekti "Aktivizimi i tregut të punës për grupet vulnerabel" që implementohet nga Agjencia e Punësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut i bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian do të mbështesë një qasje të re për aktivizimin e punësimit që përmbush nevojat e të papunëve në situata vulnerabil, siç janë shfrytëzuesit e NGM-së, dhe punëkërkuessit tjerë që e kanë vështirë për t'u punësuar në situata vulnerabil (p.sh. personat e papunë një periudhë të gjatë ose personat të ekspozuar në rrezik për shkak të papunësisë afatgjatë, me kualifikime të ulëta, ata që përballen me pengesa të shumta për të hyrë në tregun e punës, etj.). Këtyre personave do t'u ofrohet mbështetje individuale intensive për një periudhë të gjatë kohore për t'i ndihmuar ata në tejkalimin e pengesave të punësimit dhe në sigurimin dhe mbajtjen e punës së paguar me orar të plotë ose vetëpunësimit.

Këshillimi dhe Motivimi, i ashtuquajtur programi SIM, që duhet të inkurajojë dhe mbështesë procesin e përfshirjes së shfrytëzuesve të NGM-së, në trajnime dhe masa tjera aktive të punësimit, gjithashtu të mbështesë edhe përfshirjen e këtyre personave në tregun e punës dhe në punësimin. Shërbimi i mentorimit për shfrytëzuesit e NGM-së ka për qëllim të sigurojë mbështetje në përputhje me nevojat e shfrytëzuesve të NGM-së, në formën e këshillimit intensiv, punës në terren dhe kontakteve personale me shfrytëzuesit gjatë procesit të mbështetjes psiko-sociale, integrimin e shfrytëzuesve në trajnime për të përvetësuar aftësitë dhe për të fituar përvojë dhe angazhim në punë nga programet dhe masat e punësimit. Këshillimi intensiv dhe mbështetja e drejtpërdrejtë duhet të mundësojë zbulimin e pengesave dhe vështirësive personale dhe profesionale me të cilat përballlet shfrytëzuesi i NGM-së, gjatë procesit të trajnimit ose punësimit, dhe identifikimin e faktorëve dhe shkaqeve që pengojnë integrimin e shfrytëzuesve të NGM-së në mjedisin ku trajnimi ose punësimi realizohet në këshillim me profesionistë nga KJP dhe KE dhe psikoterapeutë, që ofrojnë mbështetjen psiko-sociale.

Me këtë ftesë drejtuar tenderuesve, Agjencia e Punësimit (AP) synon t'u japë kontratë shërbimi personave juridikë, përfshirë konzorciumet, dhe në partneritet dhe bashkëpunim me institucionet publike (KJP dhe Qendrat e Punësimit) do të ndihmojë, mbështesë dhe përshpejtojë procesin e aktivizimit të shfrytëzuesve të NGM-së në tregun e punës duke siguruar mbështetjen e mentorimit, që do të plotësojë mbështetjen psiko-sociale në procesin e aktivizimit të shfrytëzuesve të NGM-së.



Ky projekt financohet nga



EMPLOYMENT SERVICE AGENCY
OF THE REPUBLIC OF NORTH MACEDONIA



Aktivizimi i tregut të punës për grupet vulnerable



Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian

Procedura dhe afatet e aplikimit

Dosja e plotë e tenderit në formë elektronike është e arritshme vetëm me plotësimin e formularit të aplikimit, i cili mund të gjendet në faqen e internetit të Agjencisë së Punësimit (AP) www.av.gov.mk, dhe Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale (MPPS) www.mtsp.gov.mk.

Versioni i skanuar i formularit të aplikimit duhet të dërgohet në formatin PDF në postën elektronike në vijim:

ipa@av.gov.mk ose ipa4esarm@gmail.com.

Dokumentet e tenderit duhet të dërgohen në postën elektronike vijuese të dhënë gjithashtu në Udhëzimet për Tenderuesit:

Agjencia e Punësimit (AP)

Adresa: Rr. Vasil Gorgov Nr.43, 1000 Shkup

Afati i dorëzimit të tenderëve është e martë 23 mars 2021 në ora 15:00.

Tenderi dhe të gjitha dokumentet e kërkuara në dosjen e tenderit duhet të dorëzohen duke përdorur sistemin e zarfit të dyfishtë, përkatësisht pakoja ose zarfi i jashtëm në të cilin gjenden dy (2) zarfe të mbyllura (një për ofertë teknike dhe një për ofertë financiare) të përmbajë tekstin vijues: "**Aktivizimi i tregut të punës për grupet vulnerabël**"; „Nr. ref. 12-7581/1-6.2“ dhe s “Të mos hapet para sesionit të hapjes së ofertave” në pjesën e jashtme të zarfit.

Dokumentet e pakompletuara dhe dokumentet e dërguara pas skadimit të afatit të caktuar nuk do të merren parasysh.